

## THIRRJE E HAPUR PËR APLIKIM

Nisma "Zeri i gruas ne Media" mbështetur nga NED synon të rrisë vizibilitetin e kontributit të grave në jetën publike nëpërmjet Medias me qëllimi portretizimin e balancuar gjinor të grave si dhe nisjen e bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve dhe grave për të ndryshuar keqprezantimin e Grave në Media.

Media është vendimtare për çdo demokraci dhe luan një rol të rëndësishëm në formësimin e qëndrimeve publike. Ajo mund të përforcojë stereotipet gjinore ose ajo mund të ndihmojë në ndryshimin e mendësive, që për shumë vjet kanë penguar përpjekjet e grave për t'u bërë partnerë të plotë në proceset politike, sociale dhe ekonomike në Shqipëri.

Në këtë kuadër do të organizohen një serë aktivitetesh për të përmirësuar perceptimin dhe promovimin në Media të vajzave dhe grave në të gjitha sferat e jetës në Shqipëri.

*Trajnimi mbi aksesin dhe pjesëmarrjen në Media është një komponent i rëndësishëm i nismës që synon të zhvillojë aftësitë dhe të përmirësojë mundësitë për të qenë më vizibël në Media të 80 grave profesioniste, të cilat kanë eksperiencë në fushën e biznesit, politikës, inovacionite teknologjisë, mjedist, shëndetësië, politikës së jashtme, fushën sociale dhe në drejtësi.*

Trajnimi do të fokusohet në çështjet e mëposhtme:

- E folura në Publik
- Siguria në vetvete
- Teknikat e qasjes së gazetarëve dhe për të patur ekspozim mediatik
- Praktikimi i intervistave dhe debateve
- Si të ndajmë përvojat dhe t'i prezantojmë problematikat publikut të gjerë, për të nxitur diskutim dhe për të ngjallur interes

*Krijimi i një Hapësire të Dedikuar për gratë profesioniste në Platformën Gjinore ([www.platformagjinore.al/ekspertet/](http://www.platformagjinore.al/ekspertet/)) është një tjetër komponent po aq i rëndësishëm i nismës, i cili synon krijimin e një bazë të dhënash të 80 grave profesioniste në Shqipëri si dhe mbështetjen nëpërmjet një programi disa mujor hap pas hapi për të krijuar profilin e tyre mediatik dhe për t'u promovuar në Media.*

## **Kush mund të aplikojë?**

Gra me experiencë në fushën e biznesit, politikës, politikës së jashtme, inovacionit e teknologjisë, mjedisit, shëndetësisë, fushën sociale dhe drejtësi për t'iu dhënë mundësi gazetarëve dhe producentëve, të cilët kanë nevojë për gra profesioniste për t'i ftuar në emisionet e tyre.

## **Kualifikimi i kërkuar**

- Të jetë grua profesioniste që punon në fushat e mëposhtme: sociale, biznes, shëndetësi, mjedis, inovacion e teknologji, politikë, politikë e jashtme dhe drejtësi.
- Të jetë rezidente në rrethin e *Pogradecit*.
- Të ketë të paktën 2 vjet përvojë si eksperte në fushën e saj.
- Të jetë në dispozicion për të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve.
- Të jetë e motivuar për të kontribuar në procesin e advokimit gjinor dhe mediatik.

## **Procedura e Aplikimit**

Gratë profesioniste të interesuara nga rrethet e *Pogradecit* kërkohet të paraqesin:

- Format Aplikimi
- Një Curriculum Vitae të përditësuar të kandidatës (sipas formatit të Bashkimit Europian)

Ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj në këtë email:

[barazinevendimmarrje@gmail.com](mailto:barazinevendimmarrje@gmail.com)

*Proçesi i përzgjedhjes do të marrë parasysh balancën midis gjinisë, rajoneve gjeografike (zonave rurale dhe urbane) dhe përvojave të ndryshme.*

*Nëse keni nevojë për informacion të mëtejshëm, ju lutemi të na kontaktoni duke përdorur të njejtën adresë e-maili. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen. Ky trajnim është pa pagesë.*